



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 02/08/2022 Ref.: 1037/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 103-të, të mbajtur më 26.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** programi i studimit të Kolegjit UBT, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Muzika Moderne, Produksioni Digjital dhe Menaxhimi, BA*, 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. **Riakreditohen** programet e studimit të Kolegjit UBT, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 2. *Inxhinieria e Agrikulturës dhe Mjedisi, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik,
 3. *Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji UBT që për çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji UBT në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Muzika Moderne, Produksioni Digjital dhe Menaxhimi, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Leutrina Pireva Liburn Jupolli Tomor Kuçi Besa Llugiqi Kristina Perkola
2.	<i>Inxhinieria e Agrikulturës dhe Mjedisit, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Smajl Rizani Shkelzim Ukaj Besa Veseli Lumta Dida Vezir Jonuzi
3.	<i>Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit, MSc, 120 ECTS</i> Riakreditim	Kastriot Pehlivani Valon Durguti Violeta Lajqi Ibrahim Mehmeti

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA në datat: 09.06.2022 dhe 16.06.2022 ka organizuar vizitat në Kolegjin UBT me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Marina Novak, Kyriaki Zinoviadou, Thomas Thomadis dhe Jadranka Pekijan.

Bazuar në nenin 17 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Muzika Moderne, Produksioni Digjital dhe Menaxhimi, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht pesë (5) standarde, substancialisht një (1) standard dhe një (1) pjesërisht.
2. Për programin e studimit *Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) dhe substancialisht gjashtë (6) standarde.
3. Për programin e studimit *Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) dhe substancialisht gjashtë (6) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 103-të të mbajtur më 26.07.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit UBT dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Jasniya Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Përbashkët

